REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 718 /19
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 03. 06. 2019
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, nenit 1 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2010 për Mënyrën dhe Procedurat e Shitjes së Trungjeve Pyjore dhe Asortimenteve Drusore nga Pyjet Publike, si dhe në bazë të propozimit. nr. Ref. 45/2019 dt. 28.05.2019 të Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Lejohet shitja përmes procedurave të tenderimit e masës drusore në sasi prej 140.90 $m^3$ të konfiskuar nga prerësit ilegal në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

2. Obligohet Drejtoria për Ekonomi bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural që të inicoj procedurat e tenderimit te Drejtoria për Prokurim Publik për shitje të masës drusore të cekur në pikën paraprake të këtij vendimi, konform rregullave dhe procedurave të parapara ligjore të prokurimit publik.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
- Arkivit të Sekretarisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 719/19
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 03.06.2019
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, nenit 1 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2010 për Mënyrën dhe Procedurat e Shitjes së Trungjeve Pyjore dhe Asortimenteve Drusore nga Pyjet Publike, si dhe në bazë të propozimit. nr. Ref. 46/2019 dt. 28.05.2019 të Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Lejohet shitja përmes procedurave të tenderimit e masës drusore në sasi prej 103.90 $m^3$ e cila gjendet në terrenin e Çyqavices , e regjistruar në cfertifikaten e pronësisë P-70202010-00794-0 në vendin e quajtur Oblevik/Teraxha, pronë shoqërore Pylltaria.

2. Shitja e masës drusore të bëhet bazuar në Planin e Agjencisë Pyjore të Kosovës - Sektori Rajonal në Mitrovicë, MI/APK referencë 129/2019, për shfrytëzim të pyjeve nëpër ngastra në vitin 2019.

3. Obligohet Drejtoria për Ekonomi bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural që të inicioj procedurat e tenderimit për shitje të masës drusore të cekur në këtë vendim.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN - REPUBLIKA KOSOVO

Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
- Arkivit të Sekretarisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 756/19
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 11.06.2019
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM
## PËR FORMIM TË KËSHILLIT ORGANIZATIV

1. Formohet Këshilli Organizativ për shënimin e 17 qershorit – Ditës së Çlirimit të Komunës së Vushtrrisë, në këtë përbërje:

   1.1 **Besim Muzaqi**, Nënkryetar i Komunës - Kryesues i këshillit
   1.2 **Afrim Namani**, Drejtor për Arsim - anëtar
   1.3 **Fatmire Cecelia,** Drejtoreshë për Kulturë Rini dhe Sport - anëtare
   1.4 **Saranda Cakaj,** Drejtoreshë e Prokurimit Publik, - anëtare
   1.5 **Refik Maloku**, Drejtor për Shërbime Publike - anëtar
   1.6 **Mehmet Selaci**, Drejtor për Administratë - anëtar
   1.7 **Amir Haradinaj,** Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës- anëtar
   1.8 **Gëzim Zuqaku,** Kryetari i Shoqatës ë Familjeve të Dëshmorëve të luftës së UÇK-së – anëtar
   1.9 **Shaban Haliti** – Kryetar i Shoqatës së Invalidëve të luftës së UÇK-së – anëtar
   1.10 **Shaip Hyseni,** Kryetar i Organizatës të Veteranëve të Luftës së UÇK-së – anëtar

2. Këshilli organizativ në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për organizim të shënimit sa më solemn të kësaj date të rëndësishme.

3. Kryesuesi i Këshillit organizativ do të raportoj te kryetari i komunës lidhur me përgatitjet për këtë manifestim, mbarëvajtjen, si dhe pas përfundimit të shënimit të kësaj date.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRRISË
OPŠTINA VUČITRN
REPUBLIKA KOSOVO

Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit Organizativ
- Arkivit të Sekretarisë.